

KRONIKË SHKENCORE

ME RASTIN E EKSPOZITËS „STOLITË POPULLORE NË KOSOVË”

Me rastin e 25 Majit-Ditës së rinisë, në lokalet e Muzeut Rajonal të Herceg-Novit u hap ekspozita „Stolitë popullore në Kosovë”, dhe zgjati gjer më 15 qershor 1983. Kjo ekspozitë kishte për qëllim t'i njohë qytetarët e Herceg-Novit me një pjesë të kulturës tradicionale të KSA të Kosovës. Ekspozita është përgaditur nga Muzeu i Kosovës në Prishtinë në bashkëpunim me Muzeun rajonal të Herceg-Novit.

Materiali i ekspozuar në këtë ekspozitë është marrë nga fondet e sektorit etnografik të Muzeut të Kosovës në Prishtinë. Ky material daton nga shekujt 19 dhe 20, ndërsa numri i ekspozateve të shek. 18 është më i vogël. Janë ekspozuar 120 ekspozate, nga të cilat njëqind janë thjesht stoli, ndërsa numri tjetër janë ekspozate shoqëruese të ekspozitës. Këtu janë prezentuar lloje të ndryshme të stolive të cilat janë bajtur (e në masë më të vogël bahen e përdorohen edhe sot) në Kosovë, duke përfshirë formën e tyre, teknikat më të preferuara me të cilat janë punuar, si dhe llojet e ndryshme të materialit të stolive.

Në punimin e stolive kosovare të metalit dominojnë tri lloje të teknikave: e filigranit, e granilimit (me kokrra) dhe e derdhjes. Këto teknika janë aplikuar si të veçanta apo në kombinim njëra me tjetrën. Mjeshtrat kosovarë kanë njohur edhe teknika të tjera të punimit, mirëpo ato i kanë përdorë më rrallë. Çdonjëra prej këtyre teknikave, ose kombinimi i tyre, është njëherit edhe specifika e punëtorive të një qendre të caktuar zejtare. Kështu përdorimi i teknikës së filigranit apo të filigranit me granula, i përket punëtorive të Prizrenit. Punimet e mjeshtrave pejanë dallohen me përdorimin e teknikës së derdhjes dhe të filigranit me granula (punim më i plotë në dallim prej punimit të hollë të prizrenasve), ndërsa janjevasit kanë përdorë kryesisht teknikën e derdhjes.

Stolitë e fshatit nuk kanë pasur qendra as puntori të caktuara për punimin e tyre. Çdo fshatare ka ditur t'i rradhisë rruazat në fije peni, t'i qepë ato për pëlhure të përgaditur për këtë qëllim ose t'i punojë rruazat me grep etj.

Ndër stolitë e ekspozuara, vend të posaçëm zënë stolitë e kokës, qoftë ato të punuara në puntori zejtare apo nga vetë fshatarja. Psh. në ekspozitë janë prezentuar tri objekte të zbukurimit të kokës — „Tasfesi”, „tepellëku” dhe „kapuçi”.

Me teknikën e derdhjes dhe të rrahjes është punuar *tepellëku prej argjendi*, në formë konike, përreth të të cilit janë radhitur monedhat e argjendëta, ndërsa ana e jashtme është e zbukuruar me motive bimore dhe me një motiv zoomorf, të fituara me rrahje.

Tasfesi është i punuar prej kartoni, ka formë cilindrike dhe është i shkurtër. Ana e jashtme e tasfesis është e mbështjellur me pëlhurë të mëndafshët. Përreth janë të radhitura monedhat e imta prej mesingu, ndërsa në maje, e cila është e rrafshët, është vendosur një disk prej argjendit të praruar — i punuar me filigran, ndërsa motivet janë bimore të stilizuara.

Kapuçi është i punuar poashtu prej kartonit, në formë të konit, njëra anë e së cilit është e mbuluar me marhamë, ndërsa ana tjetër është e zbukuruar me rruaza të qepura për te. Motivët e fituara me këtë rast janë gjysëm rombe dhe rombe me vija të drejta e të shkurtëra, e që si tanësi formojnë një maskë të stilizuar.

Stolitë e ballit janë të punuara prej bakrit në formë të pllakëzave të zgjatura, të radhitura në një zingjir të hollë, poashtu prej bakri. Pllakëzat kanë nga një apo më shumë vrimëza — si zbukurim.

Në mesin e disa *gjilpërave zbukuruese* të ekspozuara, vemendjen e posaçme të tërheq ajo *me kokë* në formë të tophit, e punuar prej argjendit. Është e zbukuruar me granula të mëdha e të vogla të cilat i ndajnë motivet bimore të stilizuara të imta, të punuara me filigran.

Tamthoret janë prej argjendit, të punuara me derdhje dhe filigran. Në yllin e punuar me filigran, varen tre zinxhirë të punuar me derdhje. Dy zinxhirët anësor janë më të shkurtër dhe përfundojnë me nga një monedhë të imtë të argjendit. Për zinxhirin e mesëm varet një trekëndësh i punuar me derdhje dhe filigran. Trekëndëshi përfundon me pesë zinxhirë dekorativ.

Tufë për bystek, janë stoli për flok të cilat vendosen në bystekë — bishtaleca. Tufa ka formën e trekëndëshit të punuar prej një leckeje për të cilën janë qepur rruazat me madhësi dhe forma të njëjta, ngjyrash të ndryshme. Në dy këndet e trekëndëshit varet nga një tufëz e formës së pacaktuar, ndërsa në mes është i punuar motivi i rombit me një pikë (motiv i syrit magjik).

Në numrin e vogël të ekspozateve që i përkasin shekullit XVIII hyjnë edhe *vathët*. Kanë forma dhe madhësi të ndryshme. Këtë herë janë ekspozuar disa palë vathë më karakteristik dhe më të ruajtur, të punuar prej argjendit të praruar me kombinimin e teknikave të derdhjes, filigranit dhe të granulave. Dy format më të preferuara të kohës së cilës i përkasin — *forma e diskut dhe ajo harkore* janë shumë të zbukuruara e veçanërisht bie në sy kombinimi i bukur i teknikave dhe motiveve. Ky kombinim vërehet më së miri në vathët në formë disku. Në një pllakëz të hollë, të rrumbullakët, përreth janë të vendosura thupërza në formë të rrezeve të cilat përfundojnë me toptha të zbukuruar me granula të imta. Në mes të diskut, në anën e sipërme të vathit, shquhet një kupollëz me rombe dhe rrathë të imtë.

Gjersa qaforet dhe varëset janë më të thjeshta, qystekët, si ato të grave ashtu edhe të burrave, janë shumë të begatshme. Janë ekspozuar disa tipe të këtyre objekteve.

Qysteku i grave i punuar prej argjendit është i shkurtër, i përbërë prej tri vargjeve, në të cilat janë të radhitura rozetat e punuara me filigran, për të cilat varen „medalonet”. Këto janë prej monedhave të argjendëta të rrethuara me punim të filigranit e me motive të pacaktuara si dhe me ato bimore të stilizuara.

Qysteku i grave i punuar me rruaza ngjyrash të ndryshme, është mjaft i gjatë dhe në mes ka një katërkëndësh të punuar prej një cope të tekstilit të mveshur me rruaza, gjatë qepjes së të cilave janë fituar motive të vijës zik-zake dhe të vijës së thyer. Gjysma e zinxhirit të qystekut është prej rruazave, mbuluar me motive të rombeve të imta, për të cilin janë varë tufëza formash të ndryshme (e kumbanës, motive të stilizuara të pemës me fryte dhe e luies) Gjysma tjetër e zinxhirit është thurur prej fijeve të leshit disa ngjyrash dhe pa zbukurime të tjera.

Qusteku i burrave prej argjendi është shumë i begatshëm me zbukurime. Prej filigranit të thurur në formë të bystekut, është punuar zinxhiri i gjatë të cilin në mes e ndajnë tre toptha të punuar me derdhje, filigran dhe granula. Në njërin skaj të qystekut varet futrola e orës e punuar me rrahje dhe e zbukuruar me motive bimore.

Unazat e ekspozuara janë prej argjendit me legura, bakrit, argjendit të pastër dhe mesingut.

Unazat prej argjendit me legura janë të punuara me derdhje. I takojnë shek. 19. Zbukurimet e këtyre unazave janë bërë me forma të ndryshme të pjesës së sipërme të unazës, me gëdhendje të cekët dhe me motive të ndryshme zomorfe apo gjeometrike. Unazat e bakrit janë të thjeshta, të zbukuruar me gëdhendje të cekët, dhe me varëse të shkurtëra të cilat përfundojnë me monedha të imta të bakrit. Unazat prej argjendi janë zbukuruar me vendosjen e gurëve prej qelqit apo të masës plastike, ose në pllakëzen katrore me tekniken nielo janë fituar motive solare, apo bimore të stilizuara. Prej mesingu janë prezentuar poashtu disa tipe të unazave, në mesin e të cilave veçohet ajo me reljef, ku paraqiten dy fasada të ndërtesave e në mes tyre një motiv zoomorf.

Bylyzykët dhe brezat zënë një vend të veçant në stolitë e gruas. Gadi çdo herë janë të punuar prej materiali të njëjtë. Bylyzykët më karakteristik janë ata të bronzës së derdhur (grivnat). Janë mjaft të plotë dhe nuk mbyllen në rreth. Zbukurimet janë bërë me gëdhendje të cekët dhe me granula të mëdha. Një bylyzyk ka motivin e kryqit kurse një tjetër ka motiv të pacaktuar.

Brezi i grave, prej bakrit, është i punuar prej pllakëzave të holla dhe të ngushta, të palosura njëra përbri tjetrës dhe të përforcuara për një copë të tekstilit të plotë. Dy skajet e brezit lidhen me pafta në formë të fluturës së stilizuar.

Brezi i mesingut, është i punuar prej pllakave të derdhura në formë të katërkëndëshave, të përforcuara në një copë prej lëkure, skajet e të cilit i lidhë një unazë në mes të cilës është i punuar motivi i kryqit. Pllakat janë të zbukuruar me gëdhendje të cekët e me motive solare.

Brezi i grave — prej argjendi, është i punuar me filigran. Është shumë i zbukuruar. Përbëhet prej disa pllakave katërkëndëshe brenda të cilave janë fituar motive të stilizuara bimore dhe të pacaktuara. Dy skajet e brezit lidhen përpara — me një pllakëz në formë të fjongës.

Brezi i burrave është prej një cope të gjërë të lëkurës, në të cilën janë aplikuar granulat prej argjendi. Duke aplikuar këtë teknikë, në tërë sipërfaqen e lëkurës janë përfituar motive të pacaktuara. Ky brez i takon fillimit të shek. 18.

Monotoninë e radhitjes së stolive në vitrina dhe përgjithësisht të ekspozitës e freskojnë edhe disa objekte shoqëruese të cilat edhe po i shënojmë më poshtë.

Marhama e kokës, pjesë përbërëse e veshjes popullore të grave, është e punuar prej fijeve të holla të pambukut ngjyre krem, e zbukuruar në dy skajet e gjërësisë me motive gjeometrike. Në mes tjerash, dominojnë motivet koncentrike të gjysëmrombit, por pak të stilizuara dhe me ngjyra të qeta.

Këmisha e grave, pjesë e veshjes popullore, është e punuar në vegje, me fije të pambukut ngjyre të bardhë dhe të kafët, që gjatë endjes formojnë vija të ngushta dhe më të gjëra. Pjesa e përparme e këmishës dhe jaka janë të zbukuruar me aplikime dhe me qëndisje, duke fituar kështu motive bimore. Këtë pjesë të këmishës e mbulon qysteku prej argjendi.

Kutia për vendosjen e stolive është e punuar prej argjendi me tekni-ken e filigranit. Ka formën e arkëzës me kapak në formë të trapezitet. E tërë kutia është e zbukuruar me motive të pacaktuara.

Koburja mban vendin pranë brezit dhe disa ekspoziteve të tjera që i takojnë stolive të meshkujve. Koburja është e zbukuruar me aplikimin e filigranit në dru si dhe me inkrustim.

Pasqyrja është e punuar prej drurit dhe ka formën e paralelopipedit, mbi të cilin ngriten dy shtyllëza në mesin e të cilave është e vendosur pasqyrëja me rrethin e drurit. E tërë sipërfaqja e këtij objekti është e zbukuruar me aplikimin e motiveve gjeometrike dhe solare të zbukuruar me dhëmbëzim.

Mbulesa e djepit është e punuar prej fijeve të leshit, ngjyrash të ndryshme. Motivët gjeometrike të cilat e mbulojnë tërë sipërfaqen e kësaj mbulesë, janë fituar gjatë punimit në vegje. Dominon ngjyra e kuqe e cila ka funksion apotropeik.

Në fund po shtojmë se Muzeu i Kosovës viteve të fundit ka pasur disa ekspozita të suksesshme. Kështu ka marrë pjesë në ekspozitën Arti popullore në Jugosllavi — mbajtur në Beograd (1980), pastaj po në Beograd ka pasur ekspozitën e pavarur Pëlhurat e endura në Kosovë dhe vitin e kaluar ka marrë pjesë në ekspozitën e Lubjanës me titull Veshjet popullore në Jugosllavi, duke prezentuar me sukses veshjet popullore të KSAK. Këtë vit pra,

siç, u pa më lart, u prezentuan stolitë popullore të Kosovës. Kjo ekspozitë ishte e suksesshme dhe zgjoi interesim të madh të vizitorëve të kësaj ane. Përndryshe, Muzeu i Kosovës ekspozon, prezenton koleksionet e veta muzeale për herë të parë në RS të Malit të Zi në disa vitët e fundit.

SAZANE KULLASHI